

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
KEG Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me date 18.01 2019

Themeluesi që nënshkruan më poshtë:

ARKONSTUDIO sh.p.k regjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 19.08.2014, me NUIS L42019004I, e cila sipas Vendimit të Asambleës së Përgjithshme të datës 06.06.2018, përfaqësohet nga z. Krenar DILA, i datëlindjes 07.08.1985 identifikuar me kartën e identitetit me nr I 50807046 K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Kompania ARKONSTUDIO Sh.p.k harton kete Akt Themelimi te shoqerise KEG Sh.p.k mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU 1

Neni 1
Krijimi

Shoqeria **KEG Sh.p.k**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria **KEG Sh.p.k**, eshte një shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakut që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, ne Rrugen Frosina Plaku, Pallati 21, Shkalla A, Kati 3, Apartamenti 5. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te



krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

Financimi, projektimi, ndertimi, venia ne pune, administrimi, mirembajtja e hidrocentraleve dhe transferimi i tyre ne perfundim te kontrates tek Autoriteti Kontraktues si dhe prodhimin, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjise elektrike, ne zbatim te Kontrates se Koncesionit qe do te lidhet me Ministrine perkatese.

Neni 5 **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise **KEG Sh.p.k** eshte e pakufizuar.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 lekë (njeqind leke).

- a) Ortaku **ARKONSTUDIO SHPK** eshte zoterues i 1(nje) pjese me vlore nominale 100 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkuhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 **Mënyra te fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.



1. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
2. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
3. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartoher në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmérinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organ i Vendimmarres

Asambleja e Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakut është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financier kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.



Autorizimi mund tē jepet vetēm pēr njē mbledhje tē asamblesē sē pērgjithshme, e cila pērfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njētin rend dite.

Neni 9
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga administratori Z. Krenar DILA, shtetas shqiptar, i biri i Mihalit, lindur mē 07/08/1985, në Kolonjë Lushnje, dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi tē plotë juridike pēr tē vepruar, identifikuar nēpērmjet kartës sē identitetit me Nr. 029200075 dhe nr. personal I50807046K sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5-vjecare me te drejte riparteritje.

Asambleja e pērgjithshme mund tē shkarkojë administratoret nē çdo kohë me shumicë tē zakonshme. Statuti, apo marrëveshje tē tjera nuk mund tē pērjashtojnë apo kufizojnë këtë tē drejtë.

Përveç kësaj, administratoret shkarkohen nga gjykata pēr shkelje tē ligjit me kérkesë tē çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e pērfaqësimit tē administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen pēr regjistrim pranë Qendrës Kombëtare tē Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit nē Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 10
Kompetencat

Administratoret kane tē drejtë e detyrohen tē:

- a) kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga asambleja e pērgjithshme;
- b) pērfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pēr mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- ç) pērgatisi dhe nēnshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë sē veprimtarisë dhe, sē bashku me propozimet pēr shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pērpara asamblesë sē pērgjithshme pēr miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi nē kohën e duhur pēr rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë tē dhënat e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet nē ligjin pēr Qendrën Kombëtare tē Biznesit;
- e) raportojë pērpara asamblesë sē pērgjithshme nē lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tē posaçme me rëndësi tē veçantë pēr veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra tē tjera tē pēraktuara nē ligj dhe nē statut.

Administratori ka tē drejte tē kryeje tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshëm. Administratori pērfaqëson Shoqërinë pērpara tē gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tē huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo tē huaja, pērfshi këtu autoritetet gjyqësore tē gjitha shkallevet, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka tē gjitha kompetencat pēr tē vepruar nē marrëdhënie me tē tretët nē emër tē shoqërisë, si



perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemclare me permajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaku i shoqerise tregtare **KEG. Shpk** nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orginale.

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE KEG Sh.p.k
ARKONSTUDIO Shpk
Perfaqesuar nga administrator
Krenar DILA



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Krenar Dila'. It consists of a stylized 'D' and 'A' above a horizontal line, followed by 'Krenar' and 'Dila' written below it.